



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Leksikologji e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare
Viti / Semestri : Viti II , semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të jetë i aftë të njohë konceptet, që lidhen me ceshtjet teorike të leksikologjisë dhe semantikes të gjuhës italiane; të pasurojë leksikun e gjuhës italiane, duke mbushur dhe korrigjuar difektet dhe boshlleqet e mundshme dhe rritjen sasiore të leksikut të justifikuar nga pikepamja edhe e frekuencës së përdorimit dhe dobisë së tyre. të aftësohet të zgjidhë në të ardhmen probleme të natyrës leksikore në materiale të gjuhës italiane të folur ose të shkruar. përzgjedhë dhe krijojë tekste në mënyrë të pavarur.

Objektivat specifike lëndore:

1. Te fitojë aftësitë leksiko-semantike për të lidhur fjalët nga pikëpamja fjalëformuese, dhe të imagjinojë vlerat leksiko-semantike të tyre
2. Te dijë peshën semantike të fjalëve, sidomos atyre abstrakte që janë edhe më të vështira nga ana kuptimore, të aftësohet edhe të fitojë kapacitet të shpjegojë fjale të tilla nga ana semantike.
3. Te rrisë kompetencën leksiko-semantike indirekt edhe të kuptojë dhe të shprehet me mirë si në italishten e folur edhe atë të shkruar në mënyrë autonome.
4. Te njohë traditat, historinë, civilizimin dhe kulturën e Italisë, gjë që realizohet kryesisht nëpërmjet njohjes së mirë të leksikut.
5. Te jetë në gjendje të zhvillojë analizë argumentuese, shpjeguese për aspekte dhe fenomene leksiko-semantike të gjuhës italiane.

Rezultate të pritshme:

Lënda synon konkretisht të japë njohuri në këto fushë, që lidhen indirekt edhe me ceshtje si të antropologjisë, toponomisë, toponomastikes, kultures së një populli, huazimet, neologjizmat etj. Gjithashtu padyshim, që janë trajtuar ceshtjet e fjalformimit dhe të kompozicionit, si dy mekanizma kryesorë në çdo gjuhë për pasurimin, sistemin dhe funksionimin e një gjuhë dhe të leksikut të saj specifikisht. Analiza teorike shoqërohet me një larmi shembujsh të ciletthjeshtesojnë problematiken. Jepen edhe prirjet ose preferenca leksikore, që ka italishtja në zgjedhjen e elementeve për formimin e fjaleve të reja.